



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë nenin 22 paragrafi 1 në lidhje me nenin 45 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/20219) dhe nenin 40 paragrafi 4 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në seancën e 46 të mbajtur me datë 12.02.2021, KSHPK morri

VENDIM

Është konstatuar gjendja e konfliktit të interesave, tek personi UD Drejtor i NP, përshkak se pas emërimit në funksionin e përmendur, ka vazhduar si pronarë të menaxhon me shoqërinë aksionare, gjë që është në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Në përputhje me nenin 114 paragrafi 3 në lidhje me nenin 45 paragrafi 1, i dënuar me nenin 105 paragrafi 1 alinea 2 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, ngritet procedurë për barazim me lëshimin e urdhër-pagesës për kundërvajtje kundër personit zyrtar UD Drejtor i NP

SQARIM

Lënda me numër 09-948/1 me datë 01.03.2021 është formuar me vet-iniciativë në bazë kontrollimit të rregullt të Formularit – Deklaratë për interesa parashtruar nga UD Drejtori i NP, përshkak se pas emërimit në funksionin e përmendur, ka menaxhuar si pronarë në shoqërinë aksionare, gjë që është në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave. Në përputhje me nenin e përmendur:

- (1) *Personi i cili merr funksion me zgjedhje ose emërim, me përjashtim të personave të cilët marrin funksion i cili nuk ekzekutohet profesionalisht, nëse menaxhon me shoqëri aksionare ose institucion si pronarë, është i obliguar që parase të merr funksionin menaxhimin duhet t'ia beson personi tjetër ose trupi, përveç anëtarëve të familjes së vet, gjatë kohës derisa kryen funksionin, autorizimet publike ose obligimet.*

Personi është i emëruar për UD Drejtr në NP, pas kontrollimit të Sistemit Distribues të Regjistrimit qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me datë 12.02.2021 është vërtetuar se personi i përmendur si pronarë menaxhon me shoqërinë aksionare

Në përputhje me nenin 77 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave ky Vendim është dorëzuar deri tek personi zyrtar - UD Drejtor në NP, me të cilën tregohet për obligimin që ta menxhanton gjendjen e konfliktit të interesave, gjegjësisht menaxhimin me shoqërinë aksionare t'ia beson personi tjetër ose trupi përveç anëtarëve të familjes së tij.

Personi zyrtar – UD Drejtor në NP nevojitet që ta informon KSHPK duke shfaqur dëshmi për veprimin në afat prej 15 ditë nga dita e marrjes së këtij vendimi.

Në bazë të nenin 114 paragrafi 3 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesa, KSHPK personit të emëruar i ka shqiptuar dhe i ka dorëzuar urdhër-pagesë për kundërvajtje për shkelje të nenin 45 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, dënuar sipas nenin 105 paragrafi 1 alinea 2 nga ligji i njëjtë. Në bazë të kësaj gjendje faktike të konstatuar, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit në seancën e mbajtur me datë 12.02.2021, ka vendosi sipas dispozitave.

KOMISIONI SHTETËROR PËR
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT
Kryetarë: Biljana Ivanovska

Pas përfundimit të KSHPK
Përpunoi: K. Z., këshilltarë
Miratoi: S. P. D., anëtar i KSHPK

